

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN PETRELË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Petrelë, njësi administrative e Bashkisë Tiranë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 149, datë 07.11.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 644/10, datë 07.11.2015, i ka rekomanduar z.Erijon Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, ku përfshihet si njësi administrative ish komuna Petrelë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se në dhënien me qira të pronave të komunës Petrelë, janë aplikuar tarifat e qirasë jo në përputhje me ato të caktuara në aktet nënligjore që përkojnë me kohën e kryerjes së veprimeve juridiko-ekonomike, me diferencën -30,000 lekë/ha/vit, (*vlera e vendosur 45,000 lekë/ha/vit- 75,000 lekë/ha/vit, vlera që duhej*), cituar në nenin 2/1 të kontratës datë 6.5.2015 lidhur me firmën fituese A....., Komuna Petrelë me miratim të Këshillit të Komunës sipas vendimit nr. 30, datë 24.9.2014, me këto mangësi ka dhënë me qira tokë me sipërfaqe 30.2 ha për 30 vjet për qëllime rekreacioni dhe mbjellje pemë dekorative dhe ullishte (*sipërfaqen në përdorim e fondit pyjor (tokë jo produktive) për pasuritë nr. 748/5, nr. 748/7, nr. 748/3, nr. 748/6, nr. 550 në zonën kadastrave 1906, fshati Gurrë e Madhe, si dhe pasurinë nr. 209/1, nr. 209/2, nr. 147, nr. 253, nr. 260, nr. 79/1, nr. 79/3, nr. 79/4 në zonën kadastrave 2913, fshati Përtallesh*). Tarifa e qirasë është vendosur në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhjen nr. 2, pika 5 .

Rekomandimi: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masa dhe me grup pune të rivlerësojë procedurën e ndjekur për dhënien në përdorim të fondit pyjor me sipërfaqe totale 30.2 ha, *për qëllime rekreacioni dhe mbjellje pemë dekorative dhe ullishte*, me afat 30 vjet, sipas në kontratën datë 6.5.2015 neni 2/1 me firmën fituese A..... Këto rivlerësime të shtrihen për të gjithë kontratat që ka lidhur kjo Njësi administrative, duke reflektuar e rilogaritur diferencën e tarifës së qirasë për diferencën -30,000 lekë/ha/vit dhe kërkuar arkëtimin e tyre.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna më parë nga KLSH sipas shkresës nr. 381/6, datë 15.03.2012, konkretisht: 3 masa zhdëmtimi për vlerën **334,750 lekë** dëm ekonomik për punime të pa kryera, përkatësisht: vlera **52,750 lekë** për objektin “*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Daias*” nga subjekti “*H...*” *shpk* dhe vlera **282,000 lekë** për objektin “*Rikonstruksion i ujësjellësit Petrelë*” nga subjekti “*F...*” *shpk* si dhe 1 masë administrative për gjobë nga INUV(sot IVMKT) ndaj supervizorit *Rexhep Tarba* .

Rekomandimi: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masa, për zbatimin rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore si dhe të kryhen të gjithë hapat në shkallët gjyqësore, për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **334,050 lekë** dëm ekonomik për punime të pa kryera dhe vlerësimin për gjobë supervizorit, përkatësisht:

- vlerën **52,750 lekë** për objektin “*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Daias*” nga subjekti “*H.....*” *shpk*.

-vlerën **282,000 lekë** për objektin “*Rikonstruksion i ujësjellësit Petrelë*” nga subjekti “*F.....*” .

Brenda muajit Janar 2016

3. Gjetje nga auditimi:

-Nuk janë bërë hyrje **358 copë** pemë dekorative të llojit Blin për vlerën **5,656,400 lekë** , sipas urdhër shpenzimeve nr. 95, datë 17.5.2013 dhe nr. 114, datë 14.6.2013, në objektin: *rruga*

fshati i ri Mullet-në vazhdim, për efekt të administrimit dhe inventarizimit të tyre dhe shmangies së dublimit nga mbjelljet e mëparshme dhe të më pasme ‘.

Rekomandimi: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë, konkretisht zyra e financës të marrë masa dhe të bëjë hyrje në inventar dhe regjistrimin në kontabilitet të **358 copë pemë dekorative llojit Bli** për vlerën **5,656,400 lekë**, të marra në dorëzim e paguar sipas urdhër shpenzimeve nr. 95, datë 17.5.2013 dhe nr. 114, datë 14.6.2013, në objektin: *rruga fshati i ri Mullet-në vazhdim*, për efekt të administrimit dhe inventarizimit tyre dhe shmangies së dublimit nga mbjelljet e mëparshme dhe të më pasme.

Brenda muajit Dhjetor 2015

4. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2012-2015 në komunën Petrelë , administrimi i dokumentacionit të tenderave është jo i rregullt, pasi dosjet kanë mangësi dokumentare të theksuara, nuk janë të sistemuara dhe të kompletuara, nuk janë të inventarizuar dhe arkivuar, veprime këto në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, me nenin 30, me Modelin nr. 8 “*Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*”.

Rekomandim: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë, të marrë masa dhe të sistemojë, plotësojë, inventarizojë dhe të kryej arkivimin e të gjitha dosjeve të tenderëve të vitit 2012-2015, sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Brenda muajit Dhjetor 2015

5. Gjetje nga auditimi: Zyra e Planifikimit të Zhvillimit Territorit të ish komunës Petrelë, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve për lejet zhvillimore të ndërtimit. Kështu në fillim të dosjeve nuk kishte fletë inventarizimi me nënshkrimin e personave dorëzues dhe marrësi në dorëzim i dokumentacionit të dosjeve të Urbanistikës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*” .

Rekomandim: Bashkia Tiranë, konkretisht Drejtoria përkatëse që ka në objekt të punës Planifikimin dhe Kontrollit të Territorit të marrë masa, të arkivojë në bazë të kërkesave të ligjit për arkivat, duke inventarizuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për të gjitha praktikatat dhe lejet zhvillimore të miratuara në vitin 2013-2015, sipas kërkesave të ligjit për planifikimin dhe kontrollin e territorit.

Brenda muajit Dhjetor 2015

6. Gjetje nga auditimi: Në llogaritjen dhe harxhimin e karburantit për 6 automjetet e ish komunës Petrelë, është konstatuar si janë aplikuar norma të larta të konsumit karburantit dhe të pa argumentuara ekonomikisht. Nga verifikimi në terren rezultoi se: 2 automjetet tip “*kamion*” të komunës ishin në gjendje pune, ndërsa për 4 automjetet e tjera nuk ishin në gjendje pune (*Foristrada, Fadroma, Kamionçina, Wolzswagen*) .

Rekomandimi: Bashkia Tiranë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë për të llogaritur saktë normativat e harxhimit të karburantit për 2 automjetet “*kamion*” që janë në gjendje pune, për përmbushjen e detyrimeve në shërbimet publike, ndërsa për 4 automjetet tjera jo funksionale si Foristrada, Fadroma, Kamionçina dhe Wolzswagen të kryhen verifikimet teknike dhe dokumentare për gjendjen teknike të tyre dhe të bllokohen si jo rentabël, ndërkohë të rillogaritin harxhimin e karburantit me dokumentet që disponohen në njësinë administrative Petrelë.

Brenda muajit Dhjetor 2015

7. Gjetje nga auditimi: Në vlerësimin e gjendjes financiare të mbetur deri me datë 07.07.2015, pasi Komuna Petrelë nga kjo datë ka filluar funksionimin si Njësi administrative e Bashkisë Tiranë, rezulton se ka gjendje **fatura të pa likuiduara** për investime për vlerën **130 milion lekë**, e cila përbëhet nga:

a-100 milion lekë për fatura ku burim financimi është FZHR,

b-30 milion lekë për fatura ku burim financimi janë të ardhurat e veta të komunës.

Rekomandimi: Bashkia Tiranë për llogari të njësisë administrative Petrelë të marrë masa, duke vlerësuar në mënyrë objektive dhe saktësuar financiarisht borxhin e krijuar për vitin 2015 dhe të programojë mënyrën dhe kohën e shlyerjes së borxhit ndaj të tretëve (subjekte juridike e fizike), **për vlerën 130 milion lekë**, për të respektuar kushtet e kontratave dhe për të evituar kamat vonesat. Ndërkohë të analizojë shkaqet e krijimit të këtij borxhi dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përkatës.

8. Gjetje nga auditimi: në auditimin e kryer për taksat dhe tarifave vendore u konstatua se:

a. Debitorët e taksave vendore në ish komunën Petrelë deri më datë 1.7.2015, paraqiten për vlerën **8,774,000 lekë** për 86 subjekte fizike dhe juridike, të cilët janë pasqyruar në bilancin e vitit 2015. Mos arkëtimi i debitorëve, mungesa e marrjes së masave ndaj tyre, mungesa e lëshimit të autorizimit të ndërhyrjes me forcë të Policisë së Komunës për disiplinimin e debitorëve, bie ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", nenin 17 "Kundërvajtjet dhe sanksionet", me udhëzimin e MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore",.

b. Zyra e taksave vendore për 3 vitet (2013-2015), nuk ka planifikuar dhe nuk ka vjelur taksën e disa reklamave të vendosura në territorin e komunës në rrugën nacionale, ku ka patur mundësi arkëtimi. Veprime dhe mosveprime këto, në kundërshtim me vendimet e Këshillit Komunës Petrelë për miratimin e paketës fiskale, nr. 3, datë 6.3.2013, nr. 1, datë 2.4.2014 dhe nr.3 datë 16.01.2015.

c- 5 subjekte paraqesin vlerën 941,255 lekë mungesë të ardhurash dhe nuk janë pasqyruar në listën e debitorëve, konkretisht:

1. Subjekti juridik "I...M..." nuk ka paguar taksën e reklamës të lokalit për vlerën **40,500 lekë** për vitin 2015.

2. Subjekti juridik "A.Sh..." me veprimtari biznesi kompleks *Bar-kafe, hipizëm, pishina*, për vitin 2015 paraqitet debitor për vlerën **348,320 lekë** dhe nuk ka paraqitur certifikatën e pronësisë për efekt të saktësisë llogaritjes së taksës ndërtesës.

3. Subjekti "A.B....." për vitin 2015 nuk ka paguar detyrimet vendore për vlerën **216,380 lekë**, dhe nuk ka paraqitur certifikatën e pronësisë për efekt të llogaritjes taksës së ndërtesës.

4. Subjekti "G.M" nuk ka likuiduar detyrimet e taksave vendore në vitin, konkretisht taksa ndërtesë e lokalit, kati i parë 346 m² x 200lekë/m²=**69,200 lekë**, sipas vendimit KRRRT nr.1, datë 8.4.2011 dhe lejes përdorimit nr.182 datë 8.01.2013.

5. Subjekti juridik "Xh.D" me aktivitet "*Bar-restorant Petrelë*" nuk ka likuiduar detyrimet e taksave vendore për vitin 2011, 2012 dhe 2015. Përfundimisht subjekti nuk ka likuiduar taksat vendore nga viti 2011 deri në vitin 2015 për vlerën **266,855 lekë**.

Ndërsa subjekti juridik "M.H" nuk ka likuiduar detyrimet e taksave vendore dhe nuk ka njoftim detyrimi nga taksat vendore të komunës.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë".

Rekomandimi: Bashkia Tiranë ku përfshihet njësia administrative Petrelë, të marrë masa në bashkëpunim me Zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore e Policinë bashkiake, për:

- arkëtimin e vlerës debitorë të kontabilizuar **8,774,000 lekë** për 86 subjekte fizike dhe juridike, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore deri në sekuestrim pasurie të subjekteve debitorë **sipas pasqyrës nr. 1 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit**.

- llogaritjen dhe vjeljen e taksës për reklamat që janë vendosura në territorin e komunës në rrugën nacionale, mbështetur në të dhënat e Urbanistikës dhe IMTV.

- për kontabilizimin dhe arkëtimin e taksave vendore, për vlerën **941,255 lekë mungesë të ardhurash**, për **5 subjekte**, konkretisht: subjekti juridik "I.M" **40,500 lekë**, subjekti juridik "A.Sh" **348,320 lekë**, subjekti "A.B" **216,380 lekë**, subjekti "G.M" **69,200 lekë**, dhe subjekti juridik "Xh.D" **266,855 lekë**, të cilët nuk janë pasqyruar tek lista e debitorëve, ndërsa për subjektin juridik "M.H" llogaritjet të bëhen nga vetë institucioni.

9. Gjetje nga auditimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) të Komunës Petrelë, nuk ka zbatuar procedurat për ndarjen e tokave të lira ose dhënien me qira, pronë e komunës me sipërfaqe 38.58 ha, në zbatim të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" pika 3, dhe VKM nr. 121 datë 17.2.2011, kreu IV. Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës

(ZMMT) në komuna dhe/ose bashki, pika “e”, për të cilat mungon programi i punës nga komuna për trajtimin e kësaj prone.

Rekomandimi: Bashkia e Tiranës, njësia administrative Petrelë të marrë masa, për trajtimin e tokës arë, të lirë, në sipërfaqen 38.58 ha, të bazuar në një program pune me ekspertë të fushës, për administrimin e saj konform kërkesave ligjore në fuqi për këtë fushë, të shoqëruar këto me hartat përkatëse sipas akteve nën ligjore.

Në Vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Komuna Petrelë nuk ka zbatuar kërkesat e VKM nr. 121, datë 17.2.2011, për plotësimin e Regjistrit të tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera me resurse, të miratuar me Urdhrin e përbashkët, nr. 107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm.

Rekomandimi: Bashkia e Tiranës, njësia administrative Petrelë së bashku me Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave të marrë masat, që në bashkëpunim dhe me zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut dhe ZVRPP Tiranë, të plotësojnë Regjistrin e tokës bujqësore për Njësinë Administrative Petrelë.

Brenda muajit Shkurt 2016

11. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr.253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore”, për ngritjen e një komisioni për evidentimin, shqyrtimin, saktësimin, dhe dhënien e Akteve të Marrjes së Tokës bujqësore në Pronësi (AMTP) sipas fshatrave, kërkesë kjo e pikës 2 të këtij vendimi, për të gjithë përdoruesit faktik të tokës bujqësore të ish-kooperativës bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP). Këto kërkesa janë sipas përcaktimeve të pikës 1/1 të nenit 17 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar. Nuk ka evidenca mbi numrin e banorëve të cilët janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), sipas fshatrave dhe përmbledhëse si Komunë.

Rekomandimi: Bashkia e Tiranës, Njësia Administrative Petrelë të marrë masat, për ngritjen e një komisioni për evidentimin, shqyrtimin, saktësimin, dhe dhënien e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP) sipas fshatrave, duke shmangur kështu dhe konfliktet sociale me objekt pronësinë mbi tokën.

Brenda muajit Prill 2016

12. Gjetje nga auditimi: ZMMT e Komunës Petrelë i mungojnë proces verbalet për transferimin e zërave kadastralë tokë bujqësore në troje, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin edhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar si dhe VKM nr. 121 datë 17.2.2011, kreu IV” Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki” kreu IV, pika2, gërma’f” .

Rekomandimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave Bashkia e Tiranës, njësia Administrative Petrelë, në bashkëpunim me Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut të marrë masat për evidentimin e ndryshimeve të zërave kadastralë në regjistër të posaçëm, të shoqëruar me hartat përkatëse dhe të mbajë një kopje të dokumenteve në arkiv.

Brenda muajit Maj 2016

13. Gjetje nga auditimi; Komuna Petrelë nuk ka patur një program të miratuar nga titullari i saj, për ngritjen e grupeve të punës, që në momentin e transferimit e në vazhdim të kryerjes së inventarizimeve fizike, për përgatitjen korrekte të hartave dhe rakordimin e tyre me ZVRPP, në lidhje me identifikimin e gjendjes juridike të pasurive në momentin e përgatitjes së listave në të dy stadet e miratimeve me VKM dhe verifikimin në terren të ndryshimeve nga përcaktimet e listës për të bërë dhe azhurnimet përkatëse, në rast mospërputhjes, për pronat e transferuara pranë komunës me VKM nr.477, datë 30.05.2013, sipas listës në Projektraportin e Auditimit.

Rekomandim: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masa, për ngritjen e një komisioni të posaçëm për kryerjen e inventarizimit fizik të pronave dhe hartimin e plan vendosjeve, saktësimin në harta e në rakordim me ZVRPP, lidhur me gjendjen juridike për pronat e transferuara pranë ish komunës Petrelë, verifikimin në terren të ndryshimeve në rast

mospërputhje, duke evidentuar paligjshmërinë e statusit të tyre juridik e pronësor e sistemuar ato sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Brenda muajit Maj 2016

14. Gjetje nga auditimi: Në marrjen në dorëzim të pyjeve e kullotave, nga ish komuna Petrelë nuk është shoqëruar procesi me inventarizimin fizik të tyre në terren, për verifikimin e përcaktimeve të pasqyrës së bashkëlidhur VKM, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 804, datë 4.6.2008, mbi “*Dorëzimin e fondit pyjor dhe kullosor*” dhe me ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” neni 4/ 26, neni 11/4 dhe neni 12/f. Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë dhe njësitë vendore kufitare për territorin e shtrirjes së pyjeve, për efekt saktësimi në hartat shoqëruese të kufijve nën administrimin e ish komunës Petrelë.

Rekomandim: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masa, që të kryhet inventarizimi fizik mbi gjendjen e statusit juridik të sipërfaqes prej 1,773 ha tip kullota, livadhe shkëmbore me bimësi pyjore, të cilat me VKM nr. 554, datë 7.5.2008 janë transferuar në pronësi të komunës, si dhe të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë, që të përcaktohen kategoritë, duke tërhequr hartat përkatëse me azhurnimet e ndryshimeve, ku të përcaktohen kufijtë dhe planvendosjet e tyre.

Brenda muajit Mars 2016

15. Gjetje nga auditimi: Për menaxhimin e pasurive pyje e kullota, ish komuna Petrelë nuk ka përpiluar dhe miratuar planin e ri të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, pika 5 të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar. Nuk dokumentohen raste të bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe shoqatat e pyjeve dhe atyre mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 5/dh të VKM nr. 396 datë 21.6.2006 “*Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore*”.

Rekomandim: Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, të hartohet plani i mbarështimit të Pyjeve e kullotave dhe administrimin, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave që ndodhen në territorin e kësaj njësie , duke shfrytëzuar ato në dobi të komunitetit.

Brenda muajit Shkurt 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Tiranë, njësia administrative Petrelë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim **për shpërblimin e dëmit** me vlerën **8,376,660 lekë**, në mënyrë analitike dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve të kërkuara për arkëtim, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: U konstatua se 15 Këshilltarë të Komunës kanë përfituar padrejtësisht pagë, për vlerën **968,336 lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013, 2014 dhe 2015, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Komunës dhe borderove përkatëse, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore*” kreu VI, neni 29, pika 2 si dhe me nenin nr. 31, pika 2 dhe 8 .

Rekomandimi: Bashkia të marrë masa për arkëtimin e vlerës **968,336 lekë**, për pagesa të paligjshme për vitin 2013, 2014 dhe 2015 të 15 këshilltarëve të komunës Petrelë,(sipas listës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shkurt 2016

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Petrelë ka paguar sipas urdhër shpenzimit nr. 51, datë 18.3.2013, një gjobë të vendosur nga Ministria e Financës, për mos respektimin e kërkesave të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, sipas shkresës nr. 3241, datë 27.02.2013 dhe nr. 17900 datë 14.11.2012, për vlerën **20,000 lekë dëm ekonomik**. Kjo gjobë padrejtësisht është likuiduar nga fondet e komunës, në vend që të likuidohej nga z. Y.K ish kryetar i komunës, në cilësinë e personit autorizues dhe nga përgjegjësja e financës në cilësinë e personit zbatues .

Rekomandimi: Bashkia të arkëtojë vlerën **20,000 lekë**, përkatësisht për Y.K 10,000 lekë dhe M.Sh 10,000 lekë, në lidhje me gjobën e vendosur nga Ministria e Financës, e cila padrejtësisht është paguar nga fondet e komunës.

Brenda muajit Dhjetor 2015

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **1,451,833 lekë dëm ekonomik** (22,918,705-21,466,872), në tenderin me objekt: “*Ndërtim KUZ Daias Gurrë e Vogël për vitin 2013*”, si diferencë midis firmës fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi padrejtësisht fitues është shpallur “S... shpk me vlerën 22,918,705 lekë, në vend të operatorit ekonomik “Sa.....” shpk për vlerën 21,466,872 lekë, më ofertë të leverdishme ekonomike dhe me dokumentacion të rregullt. Njësia e prokurimit juristi ka hequr kushtin teknik, për certifikatën ISSO 9001-2009 dhe ka shtuar kushtin teknik, për certifikatën ISSO 9001-2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, sipas procesverbalit të modifikimit. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “S.....F” shpk në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit të DST pika 2/c, pasi operatori ekonomik “S....F” shpk, ka paraqitur vertetimin e pagesës së taksave vendore të Bashkisë Kamëz të parregullt nr.576 datë 4.10.2012, duke mos përfshirë pagesën e taksave vendore për vitin 2013, kërkesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST. Gjithashtu ky dokument është lëshuar jashtë afatit 3-mujor nga data e zhvillimit tenderit. Veprime në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimin publik*”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,451,833 lekë**, përkatësisht nga H.K, M.K, G.S anëtarë të KVO dhe njësia e prokurimit F.P si dhe titullari i AK Y.K me nga **290,367 lekë/secili**, për diferencë midis firmës fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi padrejtësisht fitues është shpallur “S.....F” shpk me vlerën 22,918,705 lekë, në vend të operatorit ekonomik “Sa.....” shpk për vlerën 21,466,872 lekë më ofertë të leverdishme ekonomike dhe me dokumentacion të rregullt, në tenderin me objekt: “*Ndërtim KUZ Daias Gurrë e Vogël për vitin 2013*”.

Brenda muajit Mars 2016

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Kanalizime Ujerave të Zeza Fshati Gurre e Vogël, Gurre e Re dhe Daias*” Komuna Petrelë, rezultoi vlera **105,176 lekë** pa T.V.SH dëm ekonomik, për punime të pakryera dhe diferencë çmimi, përfituar nga sipërmarrësi “S...”, në kundërshtim me kontratën nr. 1127, datë 13.06.2013 dhe preventivin e paraqitur në tender, në kundërshtim me manualin nr. 407, datë 27.06.2012 “*Për miratimin manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike tyre*”, me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **105,176 lekë**, për punime të pakryera dhe diferencë çmimi, përfituar nga sipërmarrësi “S...” shpk, për objektin “*Ndërtim Kanalizime Ujerave të Zeza Fshati Gurre e Vogël, Gurre e Re dhe Daias*” Komuna Petrelë, sipas kontratës nr. 1127, datë 13.06.2013.

Brenda muajit Mars 2016

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemim-Asfaltim Rruga Lagja Mehtan-Shkolla Mullet*” Petrelë, rezultoi vlera **455,196 lekë** pa T.V.SH dëm ekonomik nga “M....” sh.p.k, diferencë në volume pune të pakryera në vlerën 455,196 lekë pa T.V.SH, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **455,196 lekë** nga subjekti “M.....” sh.p.k, për punime të pakryera në objektin “*Sistemim-Asfaltim Rruga Lagja Mehtan-Shkolla Mullet*” Petrelë, sipas kontratës nr. 2303, datë 28.2.2012.

Brenda muajit Mars 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Ujësjellësi Fshati Qeha, Komuna Petrele*”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **671,600 lekë** pa T.V.SH dëm ekonomik, nga “H...” sh.p.k, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **671,600 lekë** nga “H.....” sh.p.k, për punime të pakryera, në objektin “*Ndërtim Ujësjellësi Fshati Qeha, Komuna Petrele*”, sipas kontratës datë 11.5.2015.

Brenda muajit Mars 2016

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Segmenti rrugor “Fshati i ri – Mullet (vazhdim) Komuna Petrelë”*”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,577,138 lekë** pa tvsh dëm ekonomik, nga “*K...” sh.p.k* dhe “*L.....I” sh.p.k*, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,577,138 lekë** nga subjektet “*K...” sh.p.k* dhe “*L.....I” sh.p.k*, për punime të pakryera, në objektin “*Segmenti rrugor “Fshati i ri – Mullet (vazhdim) Komuna Petrelë”*”, sipas kontratës nr. 2244, datë 19.12.2012.

Brenda muajit Mars 2016

8. Gjetje nga auditimi: U konstatua 1 rast diferencë e pa paguar për taksën ndikimit të infrastrukturës, për lejen zhvillimore ndërtimi nr.1554, datë 4.9.2014 për investitorin **E.Z**, për objektin “*Godinë banimi 1 kat dhe 2 kat me bodrume të pjesshme +ambiente rekreative, fshati Fikas*”, për shumën **757,381 lekë** dëm ekonomik.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **757,381 lekë** nga investori **E.Z**, për diferencë të pa paguar për taksën ndikimit të infrastrukturës, për lejen zhvillimore ndërtimi nr. 1554, datë 4.9.2014, për objektin “*Godinë banimi 1 kat dhe 2 kat me bodrume të pjesshme +ambiente rekreative, fshati Fikas*”.

Brenda muajit Dhjetor 2015

C. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi në komunën Petrelë për vitin 2013-2015, u konstatuan disa shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “*Sanksione*”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, **rekomandojmë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Tiranë**, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vlerësojë dhe marrë masë administrative me “*Gjobë në masën 50,000 lekë*”, për:

1. z. Ing. R.T, nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara, si më poshtë:

-në procedurat e zbatimit të kontratës me objektin “*Ndërtim Kanalizime Ujerave të Zeza Fshati Gurra e Vogël, Gurra e Re dhe Daias*” Komuna Petrelë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,475,176 lekë pa T.V.SH dëm ekonomik, për punime të pakryera dhe diferencë çmimi, në kundërshtim me kontratën nr. 1127, datë 13.06.2013 dhe preventivin e paraqitur në tender, në kundërshtim me manualin nr. 407 ,datë 27.06.2012 “*Për miratimin manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike tyre*”, me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar.

-në procedurat e zbatimit të kontratës me objektin “*Ndërtim Ujësjellësi Fshati Qeha, Komuna Petrelë*”, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 671,600 lekë pa T.V.SH dëm ekonomik, për volume pune të pakryera, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

-në procedurat e zbatimit të kontratës me objektin “*Segmenti rrugor “Fshati i ri – Mullet (vazhdim) Komuna Petrelë”*”, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 455,196 lekë pa tvsh dëm ekonomik, për volume pune të pakryera, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

2. z. **Ing. L.P., nën cilësinë e kolaudatores**, për shkeljet e konstatuara, si më poshtë:

- në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Segmenti rrugor “Fshati i ri – Mullet (vazhdim) Komuna Petrelë*”, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,577,138 lekë pa tvsh dëm ekonomik, për punë të pakryera, në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

- në procedurat e zbatimit të kontratës me objektin “*Sistemim-Asfaltim Rruga Lagja Mehtan-Shkolla Mullet*” Petrelë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,412,251 lekë pa T.V.SH dëm ekonomik, për vlerën 3% fond rezervë (957,055 leke) dhe për volume pune të pakryera (455,196 lekë), në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”.

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a “*llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 12 të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, **kërkojmë kryetarit të Bashkisë Tiranë**, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të marrë masa disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga Shërbimi civil*”, për punonjësit:

1. *G.S, me detyrë Përgjegjës i ZMMT Komunës Petrelë dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, për shkeljet e mëposhtme:

-për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik “S...F” shpk, në tenderin me objekt: “*Ndërtim KUZ Daias Gurrë e Vogël*” për vitin 2013”, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit të DST pika 2/c, pasi operatori ekonomik “S...F” shpk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së taksave vendore të Bashkisë Kamzë të parregullt nr. 576 datë 4.10.2012, duke mos përfshirë pagesën e taksave vendore për vitin 2013, kërkesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST, çka ka krijuar vlerën 1,451,833 lekë dëm ekonomik, pasi fitues duhej të ishte shpallur operatori ekonomik “S...” shpk për vlerën 21,466,872 lekë dhe jo “S...F” shpk me vlerën 22,918,705 lekë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “*Mungesa e konkurrencës*”, germa “a”.

-për shkelje procedurale në 3 tenderë të tjerë në objektet: “*Blerje Rërë Bituminoze*”, “*Blerje kancelari*” dhe “*Blerje karburant*”, për periudhën e vitit 2012.

- për mos zbatimin e procedurave për ndarjen e tokave të lira ose dhënien me qira, për mos plotësimin e Regjistrimit të tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve, Për mos mbajtjen e proces verbaleve të transferimit zërave kadastrave tokë bujqësore në troje, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 8752 datë 26.3.2001 “*Për krijimin edhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës*” i ndryshuar si dhe VKM nr. 121 datë 17.2.2011, kreu IV” kreu IV, pika2, germa”f”, për mos marrjen në dorëzim të pyjeve dhe mos inventarizimin fizik të tyre në terren, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 804, datë 4.6.2008, dhe me ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” neni 4/ 26, neni 11/4 dhe neni 12/f.

2. *M.K, me detyrë Sekretari i Këshillit Komunës Petrelë dhe në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, për shkeljet e mëposhtme:

-nuk ka njoftuar prefektin për mos zhvillimin e mbledhjeve të këshillit komunës deri në 6 muaj për periudhën mars-shtator 2013.

-nuk ka dërguar list-prezencën e pjesëmarrjes të 15 këshilltarëve komunar për efekt të pagesës tyre, ku si pasojë kanë përfituar shpërblim pa frekuentuar mbledhjet, për vlerën 968,336 lekë dëm ekonomik, për vitin 2013, 2014 dhe 2015

Veprime në kundërshtim me kreun VI, neni 29, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, *Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore*; nenin nr. 31, pika 2 dhe 8 si dhe nenin 37, pika 2.

3. F.P, me detyrë Jurist i Komunës Petrelë dhe në cilësinë e kryetarit të Njesisë Prokurimit, për vitin 2012-2014,

4. znj. A.T, me detyrë Juriste e Komunës Petrelë dhe në cilësinë e anëtare e Njesisë Prokurimit, për vitin 2014-2015,

5. znj.G.B, me detyrë urbaniste e Komunës Petrelë dhe në cilësinë e anëtare e Njesisë Prokurimit, për vitin 2014-2015, për shkeljet e mëposhtme:

- për anomali, mungesë dokumentesh, mos inventarizim të gjitha dosjeve të tenderëve të viteve 2012-2014, megjithëse ju la detyrë sistemimi i dosjeve brenda periudhës së auditimit, por kjo detyrë nuk u krye.

- për mos arkivim të dosjeve të tenderëve me procesverbal dorëzimi në arkivin e komunës, sipas kërkesave të nenit 15 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për arkivat”*.

- për mos arkivimin e dosjeve në arkivin elektronike të APP, në kundërshtim me udhëzimet e APP.

- për mos dërgim brenda afatit ligjor pranë APP Tiranë për vitet 2013 dhe 2014 të regjistrimit të parashikimit të prokurimeve publike dërguar me datë 18 Shkurt 2013, në vend që ti dërgonte brenda 20 janarit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu i I-rë *“Organizimi i prokurimit publik”*, pika 3, germa b *“Për regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik”* si dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve publike dërguar me vonesë në datën 22 maj 2014, në vend që ti dërgonte brenda 20 janarit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar Kreu i I-rë *“Organizimi i prokurimit publik”*, pika 3, germa d *“Raportimi i realizimeve të prokurimit publik”*.

- për mangësi dokumentare në 2 dosje të vitit 2013, në cilësinë e p/njesisë prokurimit, për hartimin e DST si:

- për mangësi dokumentare për hartimin e DST në cilësinë e përgjegjëses njësisë prokurimit si: Analizimi dhe dokumentimi i kostos së mallrave që do të prokurohen, Proces verbali për hartimin e DST, Ftesa ndaj operatorëve ekonomike, Deklarata për konfliktin e interesit për KVO, Njoftimi për fituesin e tenderit, etj, në kundërshtim me nenin 58, të LPP.

-për mos depozitimin e lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar neni 70/12 *“Depozitimi i lejes zhvillimore”* pika 1.

-për mos inventarizimin e dokumentacionit, kërkesave për leje, miratimit të lejeve sipas dosjeve përkatëse të Urbanistikës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”*.

6. A.A, me detyrë përgjegjës i zyrës Planifikimit e Zhvillimit Territorit në Komunën Petrelë, për vitin 2013-2014, për shkeljet e mëposhtme:

-për aplikim gabim të taksës së ndikimit të infrastrukturës, për lejen zhvillimore ndërtimi nr. 1554, datë 4.9.2014 çka ka shkaktuar shumë 757,381 lekë dëm ekonomik (sip. ndërtimi $2100\text{ m}^2 \times 30,050 = 63,105,000 \times 3\% = 1,893,150$ lekë në fakt arkëtimi është bërë i pjesshëm për vlerën 1,135,769 lekë sipas dokumentit të Kredins Bank datë 15 Gusht 2014).

-për mos depozitimin e lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar neni 70/12 *“Depozitimi i lejes zhvillimore”* pika 1.

-për mos inventarizimin e dokumentacionit, kërkesave për leje, miratimit të lejeve sipas dosjeve përkatëse të Urbanistikës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”*.

7. A.Ç, me detyrë inspektor i IMKTV për periudhën 01.10.2014-31.7.2015, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos plotësim kriteresh profesionale ligjore për këtë vend pune, pasi emërimi është jashtë profesionit të kërkuar inxhinier ose teknik i mesëm ndërtimi që duhet për inspektor INUV, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 *“Për Inspektimin e Ndërtimit”* neni 11”.

-për mungesë të gjurmëve dokumentare për punën e kryer, të tilla si: vendime pezullimi, vendime prishje, gjopa dhe kallëzime penale, për 162 ndërtime pa leje, sipas kërkesave të nenit 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe me nenin 15/a të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III Sanksionet, ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 etj., nenit 81 “Sanksionet” të ligjit të Urbanistikës dhe pikës 8, të VKM nr 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të Kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e Urbanistik kombëtar e Vendor”.

-për mos mbajtjen dhe mos kompletimin e dosjeve të Inspektoratit ndërtimor Urbanistik.

-për mos inventarizim dhe dorëzimin e tyre në zyrën e arkivit, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

-për mos dorëzimin me procesverbal të detyrës.

8. K.B, me detyrë përgjegjës urbanistikës në Komunën Petrelë dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për periudhën Nëntor 2014-2015, për shkeljet e mëposhtme:

- për shkelje në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt objektin “ndërtim i murit pritës të rrëshqitjes në rrugën e lagjes Baxhak”, pasi dosja e tenderit ka mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 41, të LPP, kreu V, pika 2, pikat a, b dhe c, e RrPP dhe ka aplikuar procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit kontratës” jo në rrugë elektronike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IV “Lloji dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5.

- për shkelje në tenderin e zhvilluar në vitin 2015 me objekt objektin “Ndërtim Ura Zaranike 10.0 m për vitin 2015, pasi padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues (ofertën e vetme në konkurrencë) B.O.E Sinder AB & Klajger Konstruksion, pasi mungon dokumenti i shlyerjes së faturave të energjisë elektrike për subjektin fitues Klajger Konstruksion, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26 “Kontratat për punë publike” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 7, germa ç.

- për dhënien me qira të pasurisë Rezervuar të fshatit Gurrë Petrelë me sipërfaqen 5 ha në pronësi të Komunës Petrelë, pa dokumentacionin e kërkuar, në kundërshtim me kërkesat e pikës 6, të VKM nr. 567, datë 14.7.2010 “Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së konsumatorit”.

-për mos inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit, kërkesave për leje, miratimit të lejeve sipas dosjeve përkatëse të Urbanistikës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat

-për mos depozitimin e lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar neni 70/12 “Depozitimi i lejes zhvillimore” pika 1.

II. Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Ndërprerje e kontratës punës”, për punonjësit me kontratë pune, si më poshtë:

1. M.D, me detyrë përgjegjës i zyrës taksave vendore komunës Petrelë dhe në cilësinë e antarit të këshillit të komunës, për shkeljet e mëposhtme:

-për konflikt interesi, pasi mbulon 2 detyra në Komunën Petrelë për vitin 2013, 2014 dhe 2015, si përgjegjës i zyrës taksave vendore dhe këshilltar komunar, në papajtueshmëri me funksionin e këshilltarit, në kundërshtim me nenin 25 dhe 30 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” neni 3,4/a etj.

-për lëshimin e vërtetimit nr. 2097, datë 6.11.2014 për subjektin "F..." shpk për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2014, për tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt "ndërtim i murit pritës në km 2,5 të segmentit rrugor Dajës", ku në fakt subjekti nuk i ka shlyer detyrimet vendore dhe rezulton debitor, çka ka ndikuar në kualifikimin e padrejtë të këtij subjekti fitues.

-për mosrealizimin e të ardhurave vendore për vitin 2013 dhe 2015 në masën nën 46 % dhe 37 %.

-për mos marrjen e masave dhe sanksioneve për vjeljen e debitorëve të taksave vendore në komunën Petrelë deri më datë 1.7.2015, të cilët paraqiten për vlerën 8,774,000 lekë për 86 subjekte fizike dhe juridike.

-për mos planifikim dhe vjelje të taksës të disa reklamave të vendosura në territorin e komunës në rrugën nacionale, ku ka patur mundësi arkëtimi, në kundërshtim me vendimet e Këshillit Komunës Petrelë nr. 3, datë 6.3.2013, nr. 1, datë 2.4.2014 dhe nr. 3 datë 16.01.2015.

-për mungesë bashkëpunimi me drejtorinë e Urbanistikës dhe Shërbimeve si dhe policinë komunare, për disiplinimin e subjekteve debitorë dhe të paregjistruara.

-për mos pasqyrimin si debitor në vitin 2015 dhe mos njoftim detyrimi për taksat vendore të komunës për 2 raste.

2. L.K, me detyrë inspektor i IMKTV për periudhën 01.3.2015-31.7.2015, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos plotësim kriteresh profesionale ligjore për këtë vend pune, pasi emërimi është jashtë profesionit të kërkuar inxhinier ose teknik i mesëm ndërtimi që duhet për inspektor INUV, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 11".

-për mungesë të gjurmëve dokumentare për punën e kryer, të tilla si: vendime pezullimi, vendime prishje, gjoha dhe kallëzime penale, për 162 ndërtime pa leje, sipas kërkesave të nenit 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën" dhe me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e ndërtimit".

-për mos mbajtjen dhe mos kompletimin e dosjeve të Inspektoratit ndërtimor Urbanistik.

- për mos inventarizim dhe dorëzimin e tyre në zyrën e arkivit, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

-për mos dorëzimin me procesverbal të detyrës.

3. J.K, me detyrë punonjës i sektorit shërbimeve dhe magazinier i Komunës Petrelë, për vitin 2013-2015, për shkeljet e mëposhtme:

-për parregullsi në mbajtjen dhe pranimin e fletudhëtimeve të automjeteve të komunës, pasi ishin me korrigjime, pa përcaktuar qëllimin e udhëtimit etj.

-për mos rekordim të saktë të fletudhëtimeve me sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina, pasi kilometrat e pasqyruara për rrugët e brendshme të Komunës nuk bazohen në vendimin e miratuar të Këshillit Qarkut Tiranë për distancat e rrugëve.

-për konflikt të vendit punës, pasi si magazinier dhe furnizon edhe rakordon harxhimin e karburantit nga automjetet.

-për mos hartimin e programit të punës për fadromën dhe kamionin për 6-mujorin 2015.

-për mos justifikimin e 1,896 litrave karburant dhe pjesëve të këmbimit për vlerën 744,592 lekë, të bëra dalje fadromës, e cila nga verifikimi në vend i grupit të audituesve të KLSH datë 26.8.2015, rezultoi se fadroma qëndronte e stakuar dhe ishte jashtë përdorimit.

-për mos mbikëqyrje dhe kontroll të shërbimit të pastrimit të territorit komunës Petrelë.

4. M.G, me detyrë inspektor (agjent tatimor) i zyrës taksave vendore dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vitin 2013-2015, për shkeljet e mëposhtme:

-për mosrealizimin e taksave vendore për vitet 2013-2015 ose 46 % dhe 37 %.

-për mos marrjen e masave dhe sanksioneve për vjeljen e debitorëve të taksave vendore në komunën Petrelë deri më datë 1.7.2015, të cilët paraqiten për vlerën 8,774,000 lekë për 86 subjekte fizike dhe juridike.

-për mos vjelje të taksave të tregut, hapësirës publike dhe reklamave të vendosura në territorin e komunës në rrugën nacionale, ku ka patur mundësi arkëtimi, në kundërshtim me vendimet e Këshillit Komunës Petrelë nr. 3, datë 6.3.2013, nr. 1, datë 2.4.2014 dhe nr. 3 datë 16.01.2015.

-për mungesë bashkëpunimi me drejtorinë e Urbanistikës dhe Shërbimeve si dhe policinë komunare, për disiplinimin e subjekteve debitorë dhe të paregjistruara.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, me udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe me nenin 42 të Rregullores së brendshme të Komunës.

- për shkelje në 2 tenderët të karburantit dhe blerje materiale ndërtimi për vitin 2015.

-për copëzim fondi në 1 rast në procedurat me fonde publike duke përdorur prokurim të drejtpërdrejtë, për blerje rërë bituminoze për vitin 2013 për vlerën 807,648 lekë për shtrimin e rrugëve të fshatrave të komunës Petrelë, .

5. M.A, me detyrë inspektor i zyrës taksave vendore, për vitin 2015, për shkeljet e mëposhtme:

-për mosrealizimin e të ardhurave vendore për vitin 2015 në masën nën 37 %.

-për mos marrjen e masave dhe sanksioneve për vjeljen e debitorëve të taksave vendore në komunën Petrelë deri më datë 1.7.2015, të cilët paraqiten për vlerën 8,774,000 lekë për 86 subjekte fizike dhe juridike,

-për mos planifikim dhe vjelje të taksës të disa reklamave të vendosura në territorin e komunës në rrugën nacionale, ku ka patur mundësi arkëtimi, në kundërshtim me vendimin e Këshillit Komunës Petrelë nr. 3 datë 16.01.2015.

-për mungesë bashkëpunimi me drejtorinë e Urbanistikës dhe Shërbimeve si dhe policinë komunare, për disiplinimin e subjekteve debitorë dhe të paregjistruara.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, me udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe me nenin 42 të Rregullores së brendshme të Komunës.

E. TË TJERA

I kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë që mbas analizimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimeve përkatëse, të marrë edhe masa të tjera apo veprime administrative për drejtuesit që rezultojnë me shkelje.

Po kështu, sugjerojmë trajtimin e detajuar juridik nga Bashkia Tiranë, për të gjitha shkeljet e konstatuar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit dhe po të jetë nevoja të drejtohet në Institucionet e tjera.

Nga Bashkia Tiranë, ku përfshihet njësia administrative Petrelë, nuk ka kthyer përgjigje akoma, pasi është brenda afatit 20 ditë për dërgimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri, Beqir Kuteli, Rajmond Koçi, Luan Kuka dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT